



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.07.2021,
duke filluar në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Mungoi: Egzon Azemi, Blerand Stavileci.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Pretime Preniqi, koordinatore e njësisë për të drejtat e njeriut.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi tha neve na ka ardhur një emai-il propozimi që ka qenë në seancën e kaluar për aksionarët që caktohen nga kryetari mirëpo në seancën e fundit u dakordua që të futet vetëm propozimi i Sami Borocit, mirëpo tani e kemi propozimin që të bëhet një ndryshim - plotësim nëse jeni tani dakord.

Sami Boroci tha nuk e di a mundemi ne me bërë qita për drejtorë, se kjo po i bie me përcaktuar na kompensimin e aksionarëve për drejtorë që caktohen nga kryetari.

Agim Gashi tha nëse i duhet kryetarit dhe qeverisë një vendim i yni ne e marrim.

Sami Boroci tha kjo nuk ka ardhur prej ekzekutivit, ka ardhur prej një koleges tonë .

Agim Kuleta, kryesues tha unë këtë propozim duhet me diskutojë me kryetarin që me shti në mbledhje paraprakisht.

Agim Gashi tha nëse ate nuk e pengon na e miratojmë, nëse ne nuk jemi në rregull miratim ligjërisht na përmirëson qeveria.

Fadil Gashi tha ligjërisht nuk e shoh të arsyeshme aksionarët që janë tu i paguar drejtorit, aksionarët është dashur mi paguar komuna, e jo ndërmarrjet, këtu është bërë gabimi.

Agim Kuleta, kryesues tha kjo pikë nuk është këtu në Kuvend duhet me propozuar e propozon Osmani dhe e shtim si pikë.

Jeta Rafuna tha në Vendimin e kaluarë ne kemi thënë duhet mu bërë një vendim i veçantë, duhet me ardhur një vendim i veçantë dhe kjo prapë nuk është Vendim i veçantë.

Agim Kuleta, kryesues tha proceduralisht unë besoj nuk ka problem ky plotësim se ku Vendim është fuqi që është miratuar herën e kaluar e nëse kthehet prej Qeverisë i kundërligjshëm nuk hynë fuqi, a ky mbetet i njëjtë.

Faqe 1 nga 4

Fadil Gashi tha nëse e kthen Ministria ti duhesh me anuluar edhe këtë Vendimin e vjetër.

Agim Kuleta, kryesues tha jo vetëm ndryshimet nuk ti pranon.

Vala Peshku tha Vendimi i kaluare për aksionarë, për aksionarë të emëruar prej ekzekutivit thuhet qartë se duhet mu marrë një vendim i veçantë mu trajtuar me një Vendim të veçantë .

Agim Kuleta, kryesues tha me Fatosin e bisedojmë si është ligjërisht kjo çështje.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë

R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Informatë nga Policia e Kosovës;
3. Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2";
4. Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës;
5. Propozimvenimi për plotësim ndryshimin e Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës;
6. Propozimvendimi për miratimin e Statutit të Galerisë së Qytetit Kulturore të Prishtinës;
7. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2021-2023;
8. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit të hollësishëm Prishtina e Re - Zona perëndim në Prishtinë;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Informatë nga Policia e Kosovës;

Agim Kuleta, kryesues tha në kuvend policia vjen raporton.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Informatë nga Policia e Kosovës dhe dërgohet në Kuvend.

Pika e tretë

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2";

Jeta Rafuna parashtroi pyetje që me miratimin e këtij Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2" shumë biznese që kanë mbetur pa i marr mjetet nëse ne sot e miratojmë a i marrin menjëherë mjetet.

Osman Bllaca dha sqarime se nuk është faji ynë që nuk i kanë marrë mjetet është faji i bizneseve se nuk i kanë pasur dokumentacionet në rregull, nuk i kanë plotësuar kriteret.

Jeta Rafuna tha pasi që ka ardhur kjo pako emergjente d.m.th. nuk kanë mjaftuar mjetet për bizneset që kanë aplikuar, jo që kanë pasur gabime.

Agim Kuleta, kryesues tha çështja e kohës së pagesës është faji i gabimeve, për ndryshe nuk kanë mjaftuar mjetet dhe duhet mi shtuar.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës;

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për plotësim ndryshimin e Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës;

Agim Gashi tha këtu te bordi e kemi rritjen e numrit të anëtarëve prej 5 në 7 anëtarë të bordit, 1 anëtar vjen nga Qendra Kulturore e Prishtinës, 3 nga drejtoria e Kulturës dhe 3 anëtarë nga Shoqëria Civile, në herën e parë që është miratuar ky statut e ka pasur një anëtarë të Shoqërisë civile dhe thotë ai person duhet të zgjidhet me konkurs, e tash duhet me përmirësuar te konkursi thotë personi që vjen, duhet me bërë personat që vijnë, se Statuti duhet me qenë i saktë dhe numri e luan rolin e vet se në ndryshim nuk e keni paraparë se tanë duhet me shpall për tre veta e jo vetëm për një person, është çështje teknike po është me rëndësi se prapë na kthehet.

Agim Kuleta, kryesues tha e përmirësojmë.

Vala Peshku tha zyra ligjore duhet me përmirësuar e kur të vjen në Kuvend me qenë i përmirësuar dhe mu votuar e përmirësuar.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim ndryshimin e Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për miratimin e Statutit të Galerisë së Qytetit Kulturore të Prishtinës;

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Statutit të Galerisë së Qytetit Kulturore të Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2021-2023

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2021-2023 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit të hollësishëm Prishtina e Re - Zona perëndim në Prishtinë

Agim Kuleta, kryesues tha për këtë pikë nuk ka mundur mu përgatitur me herët materiali, ky është vetëm inicim.

Agim Gashi tha se ka informacione për çka është fjala është për 50-60 parcela te lagja "Qëndresa" mbrapa ku një përqindje e madhe e këtyre nuk mund ti marrin lejet për shkak se ish plani i hollësishëm nuk ish përputh me gjendjen reale të particilizimit në terren dhe dikund për 3% deri 30% ka truall që trualli hynë në truall dhe nuk munden me marrë leje vetëm nëse bëhen dy komshi bashkë dhe leje të përbashkët ky është problemi dhe ju ka ardhur disa herë ankesa, e kam ankesën me 45 nënshkrime d.m.th. një pjesë është ndërtuar ndërsa pjesa tjetër kanë probleme kështu që është mirë mi përkrahur.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit të hollësishëm Prishtina e Re - Zona perëndim në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25.

**Procesmbajtësja
Shyhere Islami**

**Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta**



Faqe 4 nga 4